

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8162
E martë, 14 tetor 2025
Çmimi 0.50 €

Kosova përfshihet në
ECMI, një hap historik
në procesin e
integritimit evropian

FAQE 3

Kosova
përfshihet
në ECMI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"




ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZGJEDHJET LOKALE: 21 KOMUNA I ZGJODHËN KRYETARËT, 17 SHKOJNË NË BALOTAZH

BALOTAZHI, GARË EDHE MË INTERESANTE

FAQE 5



Në zgjedhjet lokale në Kosovë, më 12 tetor, qytetarët i shpërndanë pushtetet lokale në mënyrë të tillë që të mos ketë fitues apo humbës

absolutë, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike. Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

(KQZ), në 21 komuna gara zgjedhore përfundoi në raundin e parë, ndërsa në 17 të tjera do të zhvillohet balotazh

KURTI: KËTË JAVË NISIN DISKUTIMET PËR QEVERINË

F. 7



ZGJEDHJET LOKALE, ASGJË BEFASUESE!

F. 5

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



LOT GËZIMI DHE FESTË TEKSA PALESTINEZËT TAKOJNË TË BURGOSURIT E LIRUAR

F. 1

VON DER LEYEN TË MËRKURËN NË KOSOVË

F. 7

ASAMBLEJA PARLAMENTARE E NATO-S I JEP OSMANIT ÇMIMIN PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË

F. 3

EKONOMI



RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT NË MUAJIN SHTATOR

F. 8

HAPET APLIKIMI NË PROGRAMIN PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE TË CENUESHËM TË ENERGJISË ELEKTRIKE 2025-2026

F. 8

SPORT



ZIDANE NUK E FSHEH MË: KAM SYNIM TA DREJTOJ FRANCËN

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

LOT GËZIMI DHE FESTË TEKSA PALESTINEZËT TAKOJNË TË BURGOSURIT E LIRUAR



JERUSALEM, 13 TETOR - Në Ramallah të Gazës kanë arritur dy autobusë me të burgosurit palestinezë që janë liruar nga burgjet izraelite. Nën at dhe baballarët janë parë duke qarë nga gëzimi pasi janë takuar me fëmijët e tyre. Një pjesë e mirë e tyre kanë pasur dënime me

burgime të përjetshme. Disa janë parë me plagë dhe kanë pasur vështirësi të ecin, andaj janë dërguar në spitalet e mbetura funksionale për t'u trajtuar. Para se presidenti amerikan Donald Trump të flasë në Parlamentin izraelit, kryeministri Benjamin Netanyahu ka thënë se

13 tetori “do të shkruhet në histori” dhe që edhe presidenti Trump “do të jetë përgjithmonë në historinë e kombit tonë” dhe të botës. “E kemi pritur gjatë këtë moment, dhe dua t’ju falënderoj personalisht në emër të gjithë kombit”, i ka thënë Netanyahu, Trumpit.

Ai i ka falënderuar Shtetet e Bashkuara për mbështetjen e ofruar ndaj Izraelit përgjatë gjithë kohës. “Donald Trump është miku më i mirë që shteti i Izraelit ka pasur ndonjëherë në Shtëpinë e Bardhë”, ka thënë ai. Ai e ka përshkruar planin e Trumpit për paqe si hap të

rëndësishëm drejt paqes. “Jam i përkushtuar për këtë paqe. Ju jeni të përkushtuar për paqe dhe së bashku do të arrijmë paqe”, ka thënë ai gjatë fjalimit. Ai ka thënë se beson që Trumpi do të ndihmojë që Izraeli t'i normalizojë marrëdhëniet me më shumë shtete arabe.

TRUMPI PRITET ME DUARTROKITJE DHE FESTË NË PARLAMENTIN E IZRAELIT

Presidenti amerikan Donald Trump është pritur me duartrokitje dhe festë në Parlamentin e Izraelit në Jerusalem teksa e ka nisur fjalimin. “Vend i mirë, njëmend vend i mirë”, ka thënë ai. “Jemi mbledhur në një ditë gëzimi të thellë dhe shprese të madhe”. “Pas dy vjetëve të tmerrshëm në errësirë dhe robëri, 20 pengje guximtare po kthehen te familjet e tyre. Edhe 28 tjerë po vijnë në shtëpitë e tyre për të gjetur paqen në këtë vend të shenjtë”. “Armët kanë rënë në heshtje dhe rajoni është në paqe”, ka thënë Trumpi.

Trumpi e ka përfunduar fjalimin në Parlamentin izraelit, ku deklaroi se të gjithë janë dëshmitarë të një agimi historik të një Lindjeje të Mesme të re. Trumpi e përmbylli fjalimin duke thënë se “që nga dita e parë kur u krijua Izraeli modern, ne kemi qëndruar së bashku në kohë të vështira dhe në fitore e humbje”. “Dhe, gjatë kësaj jave, përkundër të gjitha, ne e kemi arritur të pamundurën dhe i sollëm pengjet në shtëpi”. Gjatë qëndrimit në Izrael ai do të takohet me familjarët e pengjeve para se të niset për në Egjipt për të nisur një samit për paqe në Lindjen e Mesme. Në këtë samit pritët të marrin pjesë 20 udhëheqës të shteteve më të fuqishme në botë. Para Parlamentit izraelit, Trumpi foli edhe se si shtetet e



Lindjes së Mesme nuk duhet të krijojë armiq, por të punojnë së bashku për të krijuar “mundësi dhe prosperitet”. Sipas udhëheqësit amerikan, “në vend që të krijojnë armë”, shtetet e këtij rajoni duhet të përqendrohen që të ndërtojnë shkollat, të investojnë në shëndetësi, industri dhe inteligjencë artificiale. “Edhe ndaj Iranit, regjimi i të cilit ka shkaktuar aq shumë vdekje në Lindjen e Mesme, dora e

miqësisë dhe bashkëpunimit është e zgjatur”, tha presidenti Trump.

Çfarë parasheh plani i Trumpit?

Sipas planit, operacionet ushtarake janë ndaluar në Gazë. Hamasit i kërkohet shkatërrim i plotë i armëve. Faza e parë parasheh atë që po ndodh sot: lirinë e pengjeve

izraelite në këmbim të të burgosurve palestinezë. Një tjetër pikë e rëndësishme ka të bëjë me dërgimin e ndihmave në Gazë, proces që tashmë ka nisur. Shtetet e Bashkuara e kanë përmendur në plan edhe udhëheqjen e Gazës në të ardhmen. Aty thuhet se “një komitet palestinez teknokratik dhe apolitik” do të qeverisë përkohësisht “me mbikëqyrje të

një trupi ndërkombëtar, Bordi i Paqes” i cili do të drejtohet nga presidenti amerikan Donald Trump. Në të do të marrin pjesë edhe liderë të tjerë shtetesh. Aty theksohet se Hamasit nuk duhet të ketë asnjë rol në qeverisje “direkte, jodirekte, apo të çfarëdo forme”. Një pjesë e mirë në plan i është kushtuar atij që ShBA-ja e quan “plan për zhvillim ekonomik”, me qëllim të rindërtimit të Gazës. Aty përmendet se “Izraeli nuk do ta pushtojë apo aneksojë Gazën” dhe që forcat izraelite do të largohen nga territori në disa faza. Plani e lë të hapur derën për një shtetësi palestineze.

Si nisi konflikti në Gazë?

Gjithçka ka filluar më 7 tetor të vitit 2023, kur militantë të Hamasit - grupit terrorist - e kanë sulmuar jugun e Izraelit, duke lënë të vrarë rreth 1 200 njerëz dhe duke marrë pengje 240 të tjerë. Izraeli, më pas, ka nisur fushatë ushtarake për ta shkatërruar Hamasin dhe, për pasojë, në Gazë besohet të kenë vdekur mbi 66 mijë persona, kryesisht gra dhe fëmijë. Lufta e ka bërë pothuajse rrafsh me tokë Gazën dhe banorët janë në zi buke, sipas grupeve ndërkombëtare për ndihma. Palët kanë një histori konfliktesh në të kaluarën.

KOSOVA PËRFSHIHET NË ECMI, NJË HAP HISTORIK NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 TETOR - Kosova përfshihet në nismën për Anëtarët Kandidatë për Zgjerim (ECMI) të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (EESC), nismë kjo e formalizuar në vitin 2023, por që Kosova kishte mbetur jashtë në mungesë të statusit të vendit kandidat për integrim në BE.

Përfshirja e Kosovës në ECMI u mundësua falë angazhimit të vazhdueshëm të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (BCSDN) dhe bashkëpunimit të ngushtë me partnerë rajonalë dhe e njëjta u përkrah edhe nga presidenti i EESC-së, Oliver Röpk.

Nëpërmjet këtij rrjeti, KCSF ka koordinuar një fushatë avokuese rajonale të mbështetur nga 104 organizata të shoqërisë civile nga e gjithë Ballkani, duke kërkuar përfshirjen e Kosovës në këtë nismë të rëndësishme evropiane. KCSF vlerëson se ky është rezultat i një përpjekjeje të gjatë të shoqërisë civile të Kosovës dhe rajonit duke treguar se zëri i shoqërisë civile, solidariteti dhe bashkëpunimi rajonal mund të sjellin ndryshime konkrete. Shoqëria civile e Kosovës tashmë do të ketë mundësi të kontribuojë drejtpërdrejt në debatet dhe politikatat që formësojnë të ardhmen evropiane krahas 27 vendeve anëtare të BE-së.

Çfarë janë EESC dhe ECMI?

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) është trupë këshilluese e BE-së që nga 1957, që sjell zërin e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë të Evropës në politikëbërje. Përmes opinionëve të tij, ky komitet këshillon vendimmarrësit e BE-së dhe

siguron dialog të strukturuar me publikun evropian. Me seli në Bruksel, EESC numëron 329 anëtarë nga 27 vendet anëtare të BE-së.

Në shtator të vitit 2023, EESC lansoi Nismën për Anëtarët Kandidatë për Zgjerim (ECMI), e cila përfshin përfaqësues të OJQ-ve dhe partnerëve social nga vendet candidate të BE-së në punën këshillimore të EESC. Përmes ECMI, EESC synon të përgatisë dhe integrojë shtetet candidate në Bashkimin Evropian edhe para anëtarësimit, duke u bërë pjesë e trupave formale të BE-së, duke marrë pjesë dhe kontribuar në diskutime që ndikojnë politikatat e BE-së, duke nisur kështu integrimin e shoqërisë civile shumë para integritit përfundimtar të shtetit.

Rëndësia e përfshirjes së Kosovës në ECMI

Kosova fillimisht kishte mbetur jashtë ECMI-së për shkak të kriterit të statusit formal të vendit kandidat. Lidhur me këtë në prill të vitit 2024 KCSF kishte nisur një reagim në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian pasi që Kosova ishte vendi i vetëm me perspektivë të anëtarësimit në BE, që nuk përfshihej në këtë nismë, duke argumentuar se mungesa e statusit kandidat nuk duhet të jetë pengesë për përfshirje të Kosovës në këtë trupë.

Duke e konsideruar këtë vendim të Komitetit si të gabuar dhe në kundërshtim me vlerat dhe parimet që promovohen nga ky institucion i BE-së, KCSF bashkë me përfaqësues tjerë të shoqërisë civile dhe sindikatave nga Kosova më 24 maj 2024, zhvilluan takim me udhëheqës të EESC-së, ku është shprehur shqetësimi për mos-përfshirje të Kosovës dhe është kërkuar korrigjimi i këtij vendimi. Për më tepër, e njëjta kërkesë është

përsëritur edhe në Konferencën e Nivelit të Lartë për shoqërinë civile që u zhvillua në Bruksel nga Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian me 24 tetor 2024. Ndërkaq në nëntor të 2024-s BCSDN, anëtare e së cilës është KCSF, kishte dorëzuar letër të nënshkruar nga mbi 100 organizata të shoqërisë civile nga Ballkani në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian me kërkesën për përfshirjen e Kosovës ECMI. KCSF vlerëson se përfshirja e Kosovës në këtë nismë është thelbësore për një bashkëpunim

më të fortë rajonal dhe për të mbështetur rrugën tonë të përbashkët drejt integritit evropian. Ky zhvillim përbën një fitore për barazinë dhe integrimin e Kosovës në proceset evropiane, duke hapur mundësi të reja për bashkëpunim, përfaqësim dhe ndikim të shoqërisë civile kosovare në agjendën e BE-së. KCSF shpreh mirënjohjen e saj të thellë për të gjithë partnerët dhe organizatat që mbështetën këtë nismë. Ky është një hap i vogël, por me domethënie të madhe,

drejt një Kosove më të përfshirë dhe më pranë Evropës së vlerave, solidaritetit dhe bashkëpunimit. Në vazhden e përpjekjeve afatgjata për fuqizimin e shoqërisë civile dhe avancimin e Kosovës drejt BE, KCSF-ja rikonfirmon përkushtimin e saj për ta çuar përpara agjendën evropiane të vendit me profesionalizëm, bashkëpunim dhe vizion të qartë, duke e bërë përfshirjen qytetare dhe demokracinë pjesë të përditshme të jetës sonë publike.



ASAMBLEJA PARLAMENTARE E NATO-S I JEP OSMANIT ÇMIMIN PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË



PRISHTINË, 13 TETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është nderuar të hënën me Çmimin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, një vlerësim që nderon leadershipin, kontributin dhe angazhimin e grave që kanë avancuar paqen, sigurinë dhe demokracinë në vendet e tyre dhe në mbarë botën.

Duke e pranuar këtë çmim, presidentja Osmani u shpreh se ky është "një nder i veçantë dhe një çmim që i dedikohet popullit të Kosovës, në veçanti të gjitha grave të Kosovës, atyre që me guxim, dinjitet e dashuri

ndihmuan ndërtimin e paqes dhe arritjen e lirisë sonë". "Paqja jonë është ndërtuar mbi sakrificën dhe guximin e tyre, ndërsa demokracia jonë është forcuar falë përkushtimit të grave që qëndruan të palëkundura në çdo hap të rrugëtimit tonë drejt lirisë e barazisë", theksoi presidentja Osmani.

Më tej presidentja Osmani theksoi se vlerësimi nga Asambleja Parlamentare e NATO-s është edhe njohje për përpjekjet e Kosovës në avancimin e Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, përmes Forumit Ndërkombëtar për

Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Qendrës Rajonale të Ekselencës, që tashmë Presidenca e Republikës i ka shndërruar në platforma të rëndësishme të bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar. Ky çmim i lartë ndërkombëtar, përveç që vlerëson leadershipin e presidentes Osmani, e vendos Kosovën ndër vendet model në botë për përfshirjen e grave në ndërtimin e paqes, forcimin e institucioneve demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Presidentja Osmani është liderja e parë nga Evropa Juglindore që nderohet me këtë çmim.



ZGJEDHJET LOKALE: NË 21 KOMUNA U ZGJODHËN KRYETARËT, 17 SHKOJNË NË BALOTAZH

BALOTAZHI, GARË EDHE MË INTERESANTE

Në zgjedhjet lokale në Kosovë, më 12 tetor, qytetarët i shpërndanë pushtetet lokale në mënyrë të tillë që të mos ketë fitues apo humbës absolutë, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike. Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në 21 komuna gara zgjedhore përfundoi në raundin e parë, ndërsa në 17 të tjera do të zhvillohet balotazh

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 13 tetor - Qytetarët në 38 komunat e Kosovës votuan më 12 tetor për zgjedhur kryetarët e rinj dhe përbërjet e reja komunale. Dalja në këto zgjedhje ka qenë rreth 40 për qind, pak më e vogël se më 2021. Votimet u zhvilluan pa ndonjë incident të madh. Në bazë të numërimit të deritanishëm të votave, në 21 komuna qytetarët kanë zgjedhur qysh në raundin e parë krerët e komunave, ndërkaq në 17 të tjera do të zhvillohet raundi i balotazhit më 9 nëntor. Prishtina, kryeqendra e Kosovës, është në mesin e komunave që do të shkojë në balotazh. Do të përballen LDK-ja dhe LV-ja. Në raundin e parë LV-ja dhe PDK-ja fituan në tri komuna, LDK-ja në dy, AAK-ja dhe

Nisma nga një komunë, edhe Ramiz Lladrovci fitoi me listën e tij në Drenas. KQZ-ja tha se pret që brenda javës ta përmbyllë numërimin e të gjitha votave, përkatësisht të asamblistëve, votave me kusht, të personave me nevojë të veçanta dhe me postë. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka bërë një përmbledhje të rezultateve të zgjedhjeve lokale të deritanishme të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ai ka thënë se zgjedhjet lokale dhanë një pamje shumë të larmishme dhe interesante të hartës politike të Kosovës, posaçërisht krahasuar me zgjedhjet paraprake. Cakolli ka thënë se, sipas rezultateve të deritanishme, balotazhi do të jetë edhe më interesant. Ai ka bërë një përmbledhje të përgjithshme të zgjedhjeve për secilën parti. “Nëse mblidhen votat e të

gjitha komunave për kandidatët për kryetarë, prin LV me rreth 27 % në nivel vendi, ndërsa për kuvendet komunale prin LDK me rreth 24 %. LV ka fituar pa balotazh në 3 komuna (Kamenicë, Podujevë, Shtime); është e para në dy komuna që shkojnë në balotazh (Gjilan, Fushë-Kosovë); dhe është e dyta në 10 komuna (Gjakovë, Kaçanik, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Viti, Vushtrri). Krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2021, LV ka bërë përparim të dukshëm. Nga asnjë komunë e fituar pa balotazh atëherë, këtë herë ka tri fitore, ndonëse numri i komunave ku del e para ka rënë nga 5 në 2. Në të njëjtën kohë, numri i renditjeve të dyta është rritur - nga 8 në 10”, ka thënë Cakolli. Sipas tij, LDK-ja ka fituar pa balotazh në dy komuna (Istog, Lipjan); është e para në gjashtë komuna që shkojnë në balotazh (Dragash, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Viti, Junik); dhe është e dyta në tri komuna (Gjilan, Fushë-Kosovë, Suharekë). “LDK ruan pothuajse të njëjtin nivel si në vitin 2021. Numri i komunave të fituara pa balotazh mbetet i pandryshuar (2), ndërsa ato ku del e para në balotazh janë rritur nga 5 në 6. Ndërkaq, renditjet e dyta kanë

rënë nga 4 në 3. PDK fituar pa balotazh në 3 komuna (Skenderaj, Ferizaj, Hani i Elezit); është e para në 4 komuna që shkojnë në balotazh (Kaçanik, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Vushtrri); dhe është e dyta në 2 komuna (Dragash, Klinë). PDK ka pësuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2021. Fitoret pa balotazh kanë rënë nga 4 në 3, komunat ku del e para nga 6 në 4, ndërsa renditjet e dyta nga 4 në 2”, ka shkruar Cakolli në “Facebook”. Sipas tij, AAK-ja ka fituar pa balotazh në një komunë (Deçan), është e para në katër komuna që shkojnë në balotazh (Gjakovë, Klinë, Rahovec, Suharekë); dhe është e dyta në një komunë (Junik). “AAK mbetet në nivel të ngjashëm me zgjedhjet e vitit 2021. Fitoret pa balotazh kanë rënë nga 2 në 1, ndërsa numri i komunave ku del e para mbetet i pandryshuar (4). Edhe renditjet e dyta janë të njëjta (1 komunë)”, ka deklaruar Cakolli. Analisti Artan Muhaxhiri vlerëson se që në raundin e parë të zgjedhjeve, secila parti shënoi sukseset dhe dështimet. “Pra, ka komuna ku [partitë] kanë pasur rezultate më të mira se që i kanë parashikuar. Por, ka edhe komuna në të cilat kanë dështuar, edhe pse kanë pritur

rezulate më të mira. Kjo vlen për të gjitha partitë”, thekson Muhaxhiri për “Radion Evropa e Lirë”. Ai thotë se qytetarët, në përgjithësi, e qartësuan trendin e ndëshkimit të improvizimeve nga ana e partive. Por, shton se në mesin e partive që garuan, nuk ka humbës ose fitues absolutë. Muhaxhiri thotë se në garën ndërmjet partive politike më 12 tetor, beteja kryesore ishte ajo për Prishtinën. “Në të kanë dështuar edhe Lëvizja Vetëvendosje, por edhe PDK-ja, pasi që LDK-ja, si rrallëherë më parë, ka pasur kandidaturë problematike të Përparim Ramës, me shumë projekte të parealizuar gjatë mandatit të kaluar dhe me fushatë premtimesh të përsëritura”, thotë Muhaxhiri. Besar Gërgi, nga Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GSLP), shpreh mendimin se “në vija të trasha, vërehet rënie e përkrahjes së përgjithshme për Lëvizjen Vetëvendosje në nivel vendi”. Kjo rënie e përkrahjes, sipas tij, është më e dukshme në Prishtinë, edhe pse Vetëvendosje e siguroi garën në balotazh. “Ka pasur pritje që do të ketë një rënie [të përkrahjes për LV-në] deri diku, por jo mbase në këtë shkallë që ka ndodhur, sa që LDK-ja të dalë e para në këtë komunë.”

Kjo mund të cilësohet, mbase, si befasia më e madhe e kësaj gare”, thotë Gërgi për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai shton se rezultatet preliminare të zgjedhjeve të 12 tetorit nuk kanë prodhuar ndryshime rrënjësore të balancave ndërmjet partive sa i përket numrit të komunave që kanë fituar.

Gërgi vlerëson se edhe gara për të parin e komunës në Mitrovicën e Jugut, ndërmjet PDK-së dhe LV-së, është mjaft befasuese për faktin se do të vazhdohet në balotazh. Por, sipas Muhaxhirit, balotazhi në këtë komunë nënkupton një lloj humbjeje për LV-në. “Është pritur një fitore pa balotazh e [Faton] Pecit [kandidat i LV-së]. Kjo do të jetë një humbje për LV-në, sepse në raport me investimet tejet të mëdha që i ka bërë në këtë fushatë, ky rezultat nuk do të duhej të ishte aspak i kënaqshëm”, thekson Muhaxhiri.


Ai vlerëson se LV-ja, në përgjithësi, mund të shihet si humbëse relative e zgjedhjeve të 12 tetorit, por jo e vetmja. “Rezultati i saj nëpër komuna është në mospërputhje të madhe me dominimin elektoral, të cilin ajo e pretendon se ende e mban në shkallë vendi. PDK-ja e ka ruajtur udhëheqjen në komunat ku ka qeverisur - Mitrovicë e Jugut, Prizren dhe Ferizaj. Mirëpo, pikëpyetje të mëdha paraqesin rezultatet në Prishtinë dhe Drenas”, thotë Muhaxhiri.

Në Prishtinë, PDK-ja u radhit e treta në garë, ndërsa në Drenas ajo humbi garën nga Lista e Ramiz Lladrovci.

Muhaxhiri vlerëson se LDK-ja mund ta ketë si “shpërblim ngushëllues” udhëheqjen në raundin e parë në Prishtinë dhe Pejë por, sipas tij, në komunat e tjera të mëdha është kryesisht e treta në garë.

AAK-ja, shton ai, u fokusua në komunat ku ka udhëhequr edhe më parë dhe ka arritur sukses relativ, por pa bërë përparim në ndonjë komunë tjetër.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se kjo parti ka një histori 12-vjeçarë në zgjedhjet lokale, me një rritje të pandalshme



dhe të jashtëzakonshme. “Rezultatet e fundit tregojnë se Vetëvendosje! është forca kryesore politike në Kosovë, duke ruajtur rritjen nga cikli në cikël dhe, njëherësh, është dhurata e urimi më i çmueshëm i popullit për 20-vjetorin e Lëvizjes Vetëvendosje!”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se në Mitrovicë u përhap një propagandë e koordinuar për fitoren pa balotazh të kandidatit të PDK-së, me dallime të mëdha në përqindje çka, sipas tij, ngre dyshime serioze që kërkojnë hetim nga organet e drejtësisë dhe të sigurisë për cenimin e

integritetit të votës dhe të shtetit. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, u është drejtuar me mirënjohje qytetarëve, duke folur për fitoret e LDK-së. “Sot disa e festojnë fitoren. Imriu, Iliri e Ruzhdiu festojnë me raund të parë. Festojmë për ta të gjithë. E merituat me punë, me durim e me besim. Urime për çdo sukses që e keni ndarë me qytetarët tuaj, për çdo fitore që është fitore e përbashkët e LDK-së dhe e gjithë Kosovës. Deri më sot keni qenë kandidat vetëm të LDK-së, nga sot e tutje jeni kryetarë të të gjithëve pa dallim. Silluni si të tillë. Disa të

tjerë, 9 sosh, i kemi në garë për një raund të ri. Le te fitojmë! Te tjerët ndërsa, që nuk e morën rezultatit që e merituan; kokën lartë. Mos e merrni si humbje, meqë gara nuk është e tillë. Është përvojë, është themel për fitoret e ardhshme, është dëshmi se LDK ka njerëz të guximshëm që nuk dorëzohen kurrë. Politika është garë e gjatë, maratonë. Dhe ne, si LDK, kemi dëshmuar se dimë të fitojmë, por edhe dimë të qëndrojmë me dinjitet kur na mungon një hap deri te fitorja”, ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se LDK-ja sot është më e fortë, më e organizuar dhe më e lidhur me njerëzit se kurrë më parë. Sipas tij, LDK-ja ka sot mbi 180 mijë vota për kuvende komunale. “Pa diskutim del partia e parë nga këto zgjedhje lokale. Rrugëtimi ynë vazhdon. Me të njëjtin përkushtim, me të njëjtin besë dhe me të njëjtin qëllim. Ju faleminderit nga zemra për fushatën, për punën, për besimin”, ka thënë Abdixhiku.

Gara zgjedhore përfundoi në 21 komuna

Sipas të dhënave preliminare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, garën pa balotazh e fitoi në tri komuna Lëvizja

Vetëvendosje (Podujevë, Kamenicë, Shtime), po aq sa edhe Partia Demokratike e Kosovës (Ferizaj, Skenderaj, Hani i Elezit). Lidhja Demokratike e Kosovës fitoi në dy komuna (Lipjan, Istog). Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e siguroi fitoren në Deçan, ndërsa Nisma në Malishevë. Në Mamushë fitoi kandidati për kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDKP), ndërsa Lista e Ramiz Lladrovci siguroi fitoren në Drenas. Lista Serbe fitoi në 9 komunat e banuara me shumicë serbe, ndërsa në Klokot prin, por shkon në balotazh me Unitetin Kombëtar Serb. Lëvizja Vetëvendosje do të garojë në balotazh në 12 komuna të tjera. Në dy prej tyre u rendit e para, ndërsa në 10 komuna kandidatët e LV-së për kryetarë janë të dytët me vota. Në balotazh do të garojë në nëntë komuna Lidhja Demokratike e Kosovës. Në gjashtë komuna ajo u radhit e para, ndërsa në tri të tjera e dyta. Partia Demokratike e Kosovës do të garojë në balotazh në gjashtë komuna, prej të cilave në katër u radhit e para, ndërsa në dy të tjera, e dyta. Në pesë komuna do të garojë në balotazh Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ku në katër u radhit e para, ndërsa në një tjetër është e dyta.



Uran Ismaili falënderon qytetarët: E ndërtuam një fushatë me respekt dhe dashuri për Prishtinën

PRISHTINË, 13 TETOR - Kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, pas përfundimit të zgjedhjeve të 12 tetorit, përmes një videoje u është drejtuar qytetarëve, aktivistëve dhe mbështetësve. “Ju falënderoj të gjithëve prej zemrës për dashurinë, besimin, mbështetjen dhe

angazhimin tuaj gjatë kësaj fushate. Ju keni qenë frymëzimi im më i madh - faleminderit për gjithçka”, tha Ismaili. Ai theksoi se fushata e tij ka qenë ndryshe nga të tjerat, e ndërtuar me respekt, me vlera dhe me dashuri të madhe për Prishtinën. “Edhe pse jemi

rritur gjithandej dhe jemi partia e dytë në Asamble, ky nuk është rezultati për të cilin kemi shpresuar, por prapë jam shumë krenar për punën ekipore dhe frymën pozitive që kemi përfaqësuar në qytet. Faleminderit të gjithëve nga zemra. Shihemi në Prishtinë”, përfundoi ai.



ZGJEDHJET LOKALE, ASGJË BEFASUESE!

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Të gjithë fitues, askush humbës:

Raundi i parë i zgjedhjeve lokale nuk solli ndonjë befasi të madhe, tërmet politik, jo se jo. Të gjithë e fituan kafshatën e përtypur që nga viti 2021. Deklaratat e partive politike para zgjedhjeve përkatësisht para rezultateve preliminare ishin kryesisht për të qetësuar votuesit dhe, në një mënyrë në korniza të pranuar. Vetëm një komunë e madhe, Ferizaj fitoi pa balotazh. Gjilani për një fije floku nuk fitoi pa balotazh. Nëse nuk janë numëruar votat e diasporës, mund të ndodhë që Gjilani të fitoi pa balotazh. Nëse shkon në balotazh, do të ketë shumë probleme ta fitojë edhe një mandat Alban Hyseni i LV-së. Pa balotazh më së shumti ka fituar Lista Serbe, nga tre komuna LV-ja dhe PDK-ja, dy i ka fituar LDK-ja ndërsa nga një kanë fituar AAK-ja, NISMA dhe partia turke në Mamushë. Dhe këtu merr fund raundi i parë, balotazhi e bënë arkitekturën e pushtetit lokal sikur edhe atij qendror. Pse, mund të pyesni dhe përgjigja ime është se: Renditja sipas fuqisë politike qendrore deri më tani LV-ja, pa balotazh, nuk e nxjerrë fituese. 1. LV-ja ka fituar pa balotazh në Podujevë, Shtime dhe Kamenicë. Në Podujevë dhe Kamenicë nuk pati balotazh, jo se partia fituese ishte e fortë por se PDK-ja ishte e dobët dhe luajti me lojtarë të gabuar. LDK-ja në Podujevë kandidatin për



kryetar e kishte jobindës kurse renditjen e listës për asamblistë e kishte klienteliste dhe jo të mbështetur në meritokraci. Kurthi ia fladiti Bulliqit grazhdin me vota me 4 milionë euro pak para ditës së votimit. 2. PDK-ja pa asnjë nevojë eksperimentoi me Drenasin dhe Kaçanikun, të parin e humbi, të dytin e ka në “teh të shpatës”, si për ta fituar ashtu edhe për ta humbur. Shkon në balotazh në 6 komuna, me LV-në në 4 komuna, me nga një komunë me LDK-në dhe AAK-në. 3. LDK-ja ka fituar dy komuna pa balotazh, në 7 komuna shkon në balotazh. Me PDK-në lufton në Dragash, me AAK-në në Junik kurse me LV-në në Pejë, Gjilan, Fushë Kosovë, Obiliq, Viti dhe Prishtinë.

4. AAK-ja ka fituar Deçanin pa balotazh. Me LDK-në është në Junik dhe Therandë, me LV-në në Gjakovë dhe në Klinë me PDK-në. Pasi LV-ja është në garë të drejtpërdrejtë me LDK-në për Prishtinën, Pejën dhe Gjilanin, nuk ka asnjë interesim për marrëveshje bashkëpunimi të ndërsjellë. LV-ja është në garë të drejtpërdrejtë me PDK-në në Prizren, Mitrovicë dhe Kaçanik prandaj nuk i duhet asnjë marrëveshje. Në anën tjetër Prishtina, Mitroica e Jugut dhe Gjilani kanë peshë jetike për LV-në, më shumë për zgjedhje të përgjithshme, se ato lokale. Për PDK-në dhe LDK-në është qenësore dhe me rëndësi të veçantë ruajtja e qyteteve të mëdha, Prishtinën, Pejën dhe eventualisht Gjilanin për LDK-në

dhe Prizrenin dhe Mitrovicën e Jugut, për PDK-në. **Si mund të realizohet kjo:** Vetëm PDK-ja mund të sigurojë fitoren e LDK-së në Prishtinë, të ndihmojë në fitoren në Pejë, Viti, Obiliq dhe të mbajë gjallë shpresën për fitore në Gjilan, Fushë Kosovë dhe Therandë. LDK-ja është vendimtare për fitore të PDK-së në Prizren, Mitrovicë të Jugut dhe Vushtrri sikur të ndihmojë edhe në Klinë dhe Kaçanik. PDK-ja duhet të gjejë rrugë të përafritimit me Ramiz Lladrovcin para datës 9 nëntor që do të ndikonte mbase edhe në Kaçanik (më shumë) si dhe në komunat tjera ku garon në balotazh. Për rezultatin aspak të mirë të LV-së në zgjedhje lokale nuk kanë faj fare exitpollet, është kërkesë qesharake kërkesa e

Kurthit për hetim të tyre. Autorët e exitpolleve nuk e kanë dëmtuar aspak LV-në por e kanë dëmtuar reputacionin e tyre. LV-në e kanë dëmtuar fjalori i shfrenuar i Kurthit, Pecit, grekes Mihali, Antikombëtarit Murati dhe Basha dhe “Çetës së Injorantëve” të LV-së. Në një situatë të mirëmbajtjes së higjienës orale gjatë deklarimeve publike, LV-ja dhe Peci do ta fitonin Mitrovicën e Jugut, pa balotazh, qartazi bindshëm. Për mua, ndonëse nuk fitoi pa balotazh, yll i këtyre zgjedhjeve është Arian Tahiri i PDK-së. Yje janë edhe Agim Aliu, Ramiz Lladrovci. Është edhe një mundësi, në dukje e pabesueshme por, në muçalin tonë politik shumë e realizueshme. PDK-ja ndihmon LV-në në Prishtinë, Gjilan, Pejë, Fushë Kosovë, Viti, Obiliq duke e përjashtuar LDK-në nga thuaja të gjitha komunat ku garon me LDK-ja në këmbim të Mitrovicës, Prizrenit etj. e që do të përfundonte me koalicion në nivel qendror ku PDK-së do t'i takonte posti i presidentit dhe kryetarit të Kuvendit! A kemi mbërrirë në nivel të tillë të çmendisë! Vështirë e besueshme por jo edhe e parealizueshme! Qeveria Kurthi 3 edhe nëse formohet (nuk e besoj), me rrëzimin e Rashiqit nga Gjykata Kushtetuese sepse zgjedhja e tij është 100 për qind në kundërshtim me Kushtetutën, në mënyrë automatike do ta rrëzonte qeverinë Kurthi 3 duke provokuar zgjedhje të parakohshme në Kosovë. Të jemi gjallë deri atëherë!

Haradinaj viziton Elezajn dhe Ramosajn, ua uron fitoren

KLINË, 13 TETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar të hënën kryetarin e Klinës, Zenun Elezaj, të cilit ia ka uruar fitoren, edhe pse ende nuk dihet nëse do të shkojë në balotazh, pasi ende nuk janë numëruar votat e diasporës. Elezaj deri më tani ka fituar 48.04 për qind të votave, që Haradinaj këtë rezultat e ka quajtur fitore bindëse. “Vërtet, kryetari Elezaj është vlerë e shtuar për Klinën. Ai ka rreth vetes njerëz profesionistë e me

vlera, që çdo ditë bëjnë më të mirën për qytetarët, si në Asamble, ashtu edhe në ekzekutiv. Jam krenar për rezultatin dhe i sigurt se pas pak ditësh, Klina do ta konfirmojë fitoren e Aleancës”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Po ashtu, ai ka vizituar edhe Bashkim Ramosajn në Deçan, të cilin e ka uruar edhe për një mandat tjetër katërvjeçar. Haradinaj ka vlerësuar se Deçani është “i pakontestueshëm” për fitoren e

AAK-së. “Deçani është i pakontestueshëm për fitoren e Aleancës dhe për vazhdimin e qeverisjes së Bashkim Ramosajt edhe për një mandat tjetër katërvjeçar. E urova kryetarin Ramosaj për këtë fitore të merituar dhe për punën e palodhshme që ka bërë për Deçanin. Nga sot, puna vazhdon me të njëjtin përkushtim dhe energji”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



Von der Leyen të mërkurën në Kosovë

PRISHTINË, 13 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, të mërkurën do të qëndrojë për vizitë zyrtare në Kosovë në kuadër të një ture që ajo do ta nisë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Vizita e saj në Kosovë vjen pas asaj që do ta zhvillojë në Tiranë, ndërsa ende nuk dihet me cilët zyrtarë të shtetit do të takohet gjatë qëndrimit të saj.

Publikimi i raportit vjetor të Komisionit Evropian, i cili zakonisht bëhet në tetor, është shtyrë për në fillim të muajit

nëntor. Kjo shtyrje lidhet me planet e vizitës së von der Leyen në kryeqytetet e vendeve të rajonit.

Raporti për Kosovën pritet të fokusohet kryesisht në ngërçin institucional në vend, ndërsa për Serbinë raporti do ta adresojë krizën e brendshme dhe protestat që po vazhdojnë prej gati një viti. Situata në Bosnjë-Hercegovinë konsiderohet si krizë shtetërore.

Ndërkaq, Maqedonia e Veriut mbetet e bllokuar në procesin e integritetit evropian për shkak të vetos së Bullgarisë.

Von der Leyen e kishte realizuar vizitën e fundit në Ballkanin Perëndimor nga 23 deri më 26 tetor 2024. Gjatë asaj vizite katërditore ajo ishte takuar me liderët e Shqipërisë, të Maqedonisë së Veriut, të Bosnjë-Hercegovinës, të Serbisë, të Kosovës dhe të Malit të Zi.

Qëllimi kryesor i udhëtimit kishte qenë promovimi i Planit të Rritjes prej 6 miliardë eurosh të Bashkimit Evropian dhe diskutimi mbi përparimin e vendeve të rajonit në rrugën e tyre drejt integritetit evropian.



KURTI: KËTË JAVË NISIN DISKUTIMET PËR QEVERINË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 TETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të hënën se këtë javë do t'i nisë diskutimet për qeverisjen qendrore.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka mandatuar Kurtin për ta formuar qeverinë e re pas konstituimit të Kuvendit më 10 tetor, me zgjedhjen e Nenad Rashiqit nënkryetar nga komuniteti serb.

Partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, por jo mjaftueshëm për ta formuar vetë udhëheqjen e re.

Kurti ka thënë se dita e fundit kur do të mund të mbahet seanca e Kuvendit, ku ai paraqet kabinetin e ri, është 26 tetori. "Kosovës i duhet edhe një mandat i qeverisë sonë, i duhet një mandat i ri i qeverisë sonë. Neve na duhet një mandat i ri në përputhje me rezultatin e 9 shkurtit sivjet. Unë si kryeministër në detyrë kam hyrë në muajin e shtatë të vitit të pestë të mandatit të plotë katërvjeçar dhe duhet të kemi mandat të rregullt, i cili padyshim se do të fillojë sapo ta nxjerrim në Kuvend përbërjen e re Kurti 3", ka thënë kryeministri në detyrë në një konferencë për medie.

"Në momentin që vlerësojmë se komunikimet kanë rezultuar të suksesshme, ne nuk e presim 26 tetorin, por ai është afati i fundit", ka deklaruar Kurti, duke mos dashur të japë hollësi se me cilat parti mund të jetë duke diskutuar ndonjë koalicion të



mundshëm qeveritar. "Nuk mund të flas më shumë në këtë fazë. Nëse nuk ka qeveri të re Kurti 3, pa asnjë dyshim që jemi të gatshëm për zgjedhje të reja parlamentare".

Albulena Haxhiu nga partia e Kurtit ka thënë ditë më parë se LV-ja mund të diskutojë me Lidhjen Demokratike të Kosovës për ndonjë koalicion të mundshëm, pasi Nisma Socialdemokrate nuk ka qenë e interesuar të përfshihet në qeverisje. Ajo e ka përjashtuar ndonjë koalicion të mundshëm me Partinë Demokratike të Kosovës dhe Listën Serbe -

partinë më të madhe të serbëve në Kosovë.

Pas mandatit të dhënë nga Osmani, Kurti i ka 15 ditë ta propozojë para Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. Kabineti duhet t'i sigurojë votat e 61 deputetëve brenda këtij afati. Por, nëse kjo nuk ndodh, presidentja është e obliguar që brenda 10 ditëve t'i ftojë në konsultim edhe një herë partitë politike dhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandataren e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë.

Edhe mandatarja e ardhshme

duhet t'i ketë 15 ditë kohë që t'ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. Nëse qeveria nuk formohet as pas 40 ditësh, presidentja duhet të shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen dyzet ditë prej shpalljes së vendimit.

Kryeministri në detyrë Kurti i ka bërë këto deklarata një ditë pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në 38 komunat e Kosovës. Sipas tij, partia Vetëvendosje e ka shënuar rezultatin më të mirë në nivel lokal.

Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, LV-ja ka

fituar në tri komuna - Podujevë, Kamenicë, Shtime, ndërsa do ta vazhdojë garën në balotazh në 12 komuna të tjera. Për njohësit e çështjeve politike, asnjëra parti nuk arriti dominim të plotë.

Dalja në këto zgjedhje ka qenë rreth 40 për qind, pak më e vogël se më 2021.

Në total, 21 komuna i kanë zgjedhur kryetarët në raundin e parë, ndërsa 17 të tjera do të organizojnë balotazhin më 9 nëntor.

Procesi zgjedhor është zhvilluar i qetë, pa incidente të mëdha.

Jashari pret në takim lamtumirës zëvendëskomandantin e KFOR-it

PRISHTINË, 13 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletjënant Bashkim Jashari, ka pritur në takim

zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneralbrigade Cahit Irican, me rastin e përfundimit të misionit të tij. Gjeneral Jashari dhe gjeneral

Irican diskutuan në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet FSK-së dhe KFOR-it. Në fund të takimit gjeneral Jashari falënderoi gjeneralin Irican

për shërbimin e tij në misionin e KFOR-it në vendin tonë dhe i uroi suksese në karrierën ushtarake.



RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT NË MUAJIN SHTATOR

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin shtator 2025, me vit bazë 2015=100.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë, në një mesatare prej 4,7 %, në muajin shtator 2025, krahasuar me muajin shtator 2024, kurse inflacioni mujor ishte (-0,2 %) në muajin shtator 2025.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4,7 % në muajin shtator 2025, krahasuar me muajin shtator 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pushime të organizuara (23,1 %); bileta të fluturimeve (22,5 %); energji elektrike (17,4 %); kafe, çaj dhe kakao (14,2 %); pemë (13 %); mirëmbajtje dhe riparime të pajisjeve personale të transportit (12,8 %); mish (12,1 %); shërbime të tjera në

lidhje me pajisjet personale të transportit (10,4 %); qumësht, djathë dhe vezë (8,8 %); shërbime hoteliere (8,3 %); shërbime ambulatore (7,3 %); vajra dhe yndyrna (6,8 %); perime (5,8 %); pije alkoolike (4,7 %); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (4,4 %); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (4,3 %); kujdes personal (4,1 %); bukë dhe drithëra (3,8 %); arsim i paklasifikuar sipas nivelit (3,8 %); gazeta, libra dhe materiale për zyra (3,8 %); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (3,6 %); furnizim me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3,5 %); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (3,5 %); duhan (3,4 %); gjëra personale (3,2 %); këpucë (3,2 %); sheqer, reçel, mjaltë, çokolllatë dhe ëmbëlsira (3,2 %); veshje (1,9 %); dhe ndryshime të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të disa nëngrupe, me një ndikim të vogël në IHÇK, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 4,9 për qind në IHÇK. Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it:



karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-3,1 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0,2 %) në IHÇK. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej -0,2% në muajin shtator 2025 krahasuar me

muajin gusht 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-3.6 %), pemët (-2.8 %), biletat e fluturimeve (-1.6 %), energjia elektrike (-1.2 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në

IHÇK-it. Ndërsa ngritje e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (1.4 %), qumështi, djathi dhe vezët (1.1 %), blerja e automjeteve (0.6 %) dhe shërbimet hoteliere (0.4 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,2-përqindësh në IHÇK-it.

MBAHET SESIONI INFORMUES ME BIZNESE PËR SKEMËN E GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR

PRISHTINË, 13 TETOR - Është mbajtur sesioni i parë informues me bizneset rreth Skemës së Grantëve për Energji të Pastër, me ç'rast u njoftua se tashmë është hapur aplikimi në e-Kosova.

Bizneset u informuan se mbështetja do të jetë në vlerë deri në 25 mijë euro për biznes, ndërsa projekti është financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut e zbatuar nga KIESA/MINT, në partneritet me Ministrinë e Ekonomisë (ME) dhe LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Gjatë këtij sesioni, Zef Dedaj, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm në KIESA, Gent Berisha, ushtrues detyre i udhëheqësit të Sektorit për



Projekte në Fushën e NVM-ve në KIESA dhe Mirlinda Bajrami, zyrtare e lartë e të dhënave në Departamentin e Energjisë të Ministrisë së Ekonomisë, i informuan bizneset lidhur me skemën e grantëve për energji të

pastër dhe për udhëzuesit përkatës. Përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë u interesuan të njoftohen më shumë rreth thirrjes të cilët shtruan pyetje të ndryshme për përfitimet që do të kenë nga

granti dhe për mënyrën e aplikimit.

Skema e Grantëve për Energji të Pastër zbatohet përmes tri thirrjeve të veçanta publike të cilat përfshijnë masat: 1. Mbështetje për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike. 2. Mbështetje për masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve. 3. Mbështetje për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit. Brenda kësaj skeme do të përkrahen bizneset në sisteme solare për prodhim të energjisë elektrike, sisteme solare për ngrohjen e ujit, eficiencën e energjisë përmes investimeve në izolim të ndërtesave, bateri për sisteme solare FV, si dhe

shndërrues frekuencor për të rritur eficiencën e pajisjeve që prodhuesit tashmë i kanë në përdorim.

Skema e Grantëve për Energji të Pastër do të ofrojë deri në 20 000 euro për një masë të vetme, deri në 25 000 euro për masa të kombinuara.

Përveç financimit, skema do të ofrojë edhe ngritje kapacitetesh dhe asistencë teknike për përfituesit, duke siguruar që investimet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Kjo skemë është financuar me një buxhet prej 1 000 000.00 euro nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe zbatohet nga KIESA/MINT në partneritet me Ministrinë e Ekonomisë, LuxDev, Agjencinë e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Hapet aplikimi në programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike 2025-2026

PRISHTINË, 13 TETOR - Nga 13 tetori qytetarët mund të aplikojnë për subvencionim të energjisë përmes platformës eKosova, te Shërbimet - Grante dhe Subvencione.

Familjet që kanë aplikuar vitin e kaluar nuk kanë nevojë të riaplikojnë, pasi të dhënat e tyre janë bartur automatikisht për vitin 2025. “Megjithatë, nëse keni ndryshuar ndonjë informacion, si numri i

anëtarëve të familjes, vendbanimi apo njehësori elektrik, ato mund t'i përditësoni lehtësisht në të njëjtin formular, duke bërë ndryshimet dhe më pas duke klikuar 'Apliko', ka njoftuar Ministria e Financave.

Ky program synon t'i mbështesë familjet më të cenueshme gjatë stinës së dimrit për ta lehtësuar përballjen me shpenzimet e energjisë elektrike.

Kriteret kryesore të përfitimit: Shtetas të Republikës së Kosovës; Të ardhura deri në 150 euro për anëtar; Pasuri të paluajtshme deri në 100 000 euro.

Subvencioni realizohet sipas formulës së përllogaritjes e cila është e bazuar në të ardhurat mesatare të familjes dhe lartësisë faturës së energjisë elektrike për muajin përkatës. “Aplikimi mbetet i hapur për 6 muaj, por ftojmë



të gjithë aplikuesit e rinj dhe ata të vitit të kaluar që kanë ndryshime në të dhënat e tyre që të aplikojnë në muajin

tetor pasi pagesat në mënyrë retroaktive nuk do të realizohen”, ka njoftuar Ministria e Financave.

DONALD TRUMP I JEP RUSISË DY ZGJIDHJE



Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, po shqyrton dërgimin e raketave Tomahawk me rreze të gjatë veprimi në Ukrainë, duke thënë se kjo do të siguronte “një hap të ri agresioni” në luftën e saj me Rusinë. Kur u pyet në Air Force One nëse do të dërgonte Tomahawk në Ukrainë, Trump u përgjigj “do ta shohim... Mund ta bëj”. Kjo vjen pas një telefonate të dytë në fundjavë midis Trump dhe presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky, i cili kërkoi aftësi më të forta ushtarake për të nisur kundërsulme kundër

Rusisë. Moska e ka paralajmëruar më parë Washingtonin kundër ofrimit të raketave me rreze të gjatë veprimi për Kievin, duke thënë se kjo do të shkaktonte një përshkallëzim të madh të konfliktit dhe do të tendoste marrëdhëniet SHBA-Rusi. Raketat Tomahawk kanë një rreze veprimi prej 2,500 km, gjë që do ta vinte Moskën brenda mundësive të Ukrainës. Trump foli me gazetarët ndërsa fluturonte për në Izrael. Ai tha se ndoshta do të fliste me Rusinë në lidhje me Tomahawk-ët e

kërkuar nga Ukraina. “Mund t’u them atyre (Rusisë, red.) se nëse lufta nuk zgjidhet, mund të zgjidhet, mund të mos zgjidhet, por mund ta bëjmë”. “A duan ata (Rusia, red.) që raketat Tomahawk të shkojnë në drejtimin e tyre? Nuk mendoj kështu”, tha presidenti amerikan. Kiev ka bërë kërkesa të shumta për raketa me rreze të gjatë veprimi, ndërsa po peshon përpjekjet për të goditur qytetet ruse larg vijave të frontit të konfliktit të ashpër. Në telefonatat e tyre, Zelensky

dhe Trump diskutuan përpjekjen e Ukrainës për të forcuar aftësitë e saj ushtarake, duke përfshirë forcimin e mbrojtjes ajrore dhe armëve me rreze të gjatë veprimi. Qytetet ukrainase, përfshirë Kievin, janë përballur me bombardime të përsëritura të rënda ruse me dronë dhe raketa. Rusia ka synuar veçanërisht infrastrukturën energjetike të Ukrainës, duke shkaktuar ndërprerje të energjisë elektrike. Muajin e kaluar, i dërguari special i Trump në Ukrainë, Keith Kellogg, sugjeroi se

presidenti amerikan kishte autorizuar sulme thellë në territorin rus, duke i thënë Fox News se “nuk ka gjëra të tilla si streha” nga sulmet në luftën Rusi-Ukrainë. Rusia, e cila nisi pushtimin e saj të plotë të Ukrainës në shkurt 2022, minimizoi shanset që raketat Tomahawk të ndryshojnë rrjedhën e luftës. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha muajin e kaluar: “Qofshin Tomahawks apo raketa të tjera, ato nuk do të jenë në gjendje ta ndryshojnë dinamikën”.

AS ARMËT E AS METALET E RRALLA, JA PSE PO BËHET “LUFTË” MES SHBA DHE KINËS

Përplasja ekonomike mes Shteteve të Bashkuara dhe Kinës ka marrë një kthesë të papritur, këtë herë, në fushat dhe kuzhinat e botës. Pekini ka ndërprerë blerjen e sojës amerikane si kundërpërgjigje ndaj rritjes së tarifave doganore të vendosura nga administrata e presidentit Donald Trump, duke i hapur derën Argentinës si furnizues të ri në tregun aziatik. Në të njëjtën kohë, Sekretari i Thesarit të SHBA-së, Scott Bessent, njoftoi përfundimin e

një marrëveshjeje financiare me Buenos Airesin, që parashikon një ndihmë prej 20 miliardë dollarësh për qeverinë e Javier Mileit. Ndihma synon të stabilizojë rezervat e ulëta valutore të Argentinës dhe të forcojë aleancën politike mes dy vendeve, pasi Milei është një mbështetës i hapur i republikanëve amerikanë, shkruan A2 CNN. Megjithatë, menjëherë pas këtij zhvillimi, Kina ka nënshkruar një marrëveshje të re tregtare me

Argjentinën për importin e sojës. Ky vendim është një goditje e rëndë për fermerët amerikanë, të cilët varen nga tregu kinez si blerësi kryesor. Trump ka premtuar një “plan shpëtimi” prej 10 miliardë dollarësh për të kompensuar humbjet, por detajet e tij ende nuk janë bërë publike. Për momentin, duket se beteja për ndikim ekonomik mes SHBA-së dhe Kinës po zhvendoset nga teknologjia, drejt tryezës së çdo konsumatori në botë.



HAMASIT I DEL “ARMIK” I RI LUFTIME TË ASHPRA, 30 TË VDEKUR GJATË FUNDJAVËS!



Gati 30 të vrarë është bilanci i përleshjeve të ashpra që shpërthyen në qytetin e Gazës mes forcave të Hamasit dhe anëtarëve të armatosur të familjes Dughmush, në atë që konsiderohet si një nga konfrontimet e brendshme më të dhunshme që nga përfundimi i

operacioneve të mëdha izraelite në enklavë. BBC citon dëshmitarë okularë të pohojnë se pjesëtarë me maska të Hamasit shkëmbyen zjarr me luftëtarë të klanit në fjalë pranë një spitali të qytetit. Një zyrtar i lartë i ministrisë së brendshme të drejtuar nga

Hamasi u shpreh se njësitë e tyre të sigurisë kishin rrethuar anëtarët të klanit, me të cilët u angazhuan në luftime të ashpra. Burime mjekësore folën për 19 të vrarë nga klani Dughmush dhe tetë nga radhët e Hamasit që prej ditës së shtunë, kur nisën luftimet. Përleshjet shpërthyen në lagjen

Tel al-Haëa të qytetit, cka mbolli panik në zonë. “Këtë herë banorët nuk po iknin nga sytë këmbët prej sulmeve izraelitëve; ata po i largoheshin njerëzve të vet”, u shpreh një dëshmitar. Të dyja palët fajësojnë njëra-tjetrën për nxitjen e luftimeve.

Raportet nga terreni tregojnë se Hamasi ka mobilizuar rreth 7,000 anëtarë të forcave të tij të sigurisë për të rivendosur kontrollin mbi zonat e Gazës të liruara së fundmi nga trupat izraelite, edhe pse ai vetë e mohon të jetë duke vendosur “luftëtarët e tij nëpër rrugë”.

‘NEGOCIATOR I SHKËLQYER’, TRUMP ZBULON SE KUSH FSHIHET PAS PLANIT TË PAQES MES IZRAELIT DHE HAMASIT: AI ËSHTË TALENT



Presidenti Donald Trump, gjatë fjalës së tij në parlamentin izraelit, tregoi se kush ishte negociatori që arriti planin e paqes mes Hamasit dhe Izraelit. Ai tha se Stiv Witkoff ishte personazhi që ka kontribuar në realizimin dhe jetësimin e planit të paqes në Gaza. Ai mes të tjerash tha se Witkoff kishte pasur më parë një takim të gjatë prej 5 orësh me Putinin, me të

cilin kishte folur për ‘gjëra interesante’. “Ky është fillimi i një epoke. Duhet të shpreh mirënjohjen për punën e bërë. Brezat do të kujtojnë se gjithçka do të ndryshojë për mirë. Do të jetë epoka e artë e Izraelit dhe të Lindjes së Mesme që do të punojnë bashku. Të gjithë u munduan. Dua të falënderoj mikun tim Stiv Witkoff. Ai u zgjodh


nga unë. Kishte aftësi të jashtëzakonshme negociimi. I telefonova Steve Witkoff dhe ai ishte në një takim në fakt. Ai ishte takuar me Putinin dhe 3 orë ose 4 bisedime me pas aq orësh i thash; për çfarë drejt po flisnit për 5 orë? Më tha; për disa gjëra interesante. Ai është një talent. Është negociator i shkëlqyer. Faleminderit Witkof.”, tha ai.

MARRËVESHJA E PAQES NË GAZA, HAMASI DORËZON PENGJET E PARA

Në një zhvillim të rëndësishëm dhe të shumëpritur, 20 pengje izraelite do të lirohen sot përmes korridorit Netzarim, si pjesë e një marrëveshjeje shkëmbimi mes Izraelit dhe përfaqësuesve palestinezë. Izraeli ka pranuar të lirojë 1,950 të ndaluar dhe të burgosur afatgjatë palestinezë në këmbim të këtyre 20 pengjeve. Dy prej pengjeve izraelite ndodhen në gjendje kritike shëndetësore. Në një gest simbolik, Kryeministri Benjamin Netanyahu ka përcjellë një shënim të shkruar me dorë për pengjet, ku thuhet: “Mirë se erdhët përsëri!” Ndërkohë, turmat janë mbledhur në Sheshin e Pengjeve në Tel Aviv

dhe qytete të tjera, duke pritur me ankth dhe emocione kthimin e pengjeve. Nga ana tjetër, të burgosurit palestinezë janë parë duke hipur në autobusë nën masa të rrepta sigurie, ndërsa automjetet e Kryqit të Kuq janë në gatishmëri për të siguruar transferimin human dhe mjekësor. Po ashtu, ka mbërritur ndihma e parë humanitare për banorët e uritur të Gazës, shënuar si një tjetër hap i rëndësishëm në këtë ditë me zhvillime dramatike. Ngjarja po ndiqet nga afër nga komuniteti ndërkombëtar, mes shpresave për lehtësim tensionesh dhe një përparim të mundshëm drejt qetësisë në situatën në rajon.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

ZIDANE NUK E FSHEH MË: KAM SYNIM TA DREJTOJ FRANCËN



PARIS, 13 TETOR - Trajneri Zinedine Zidane e ka pranuar publikisht se ëndërron ta drejtojë kombëtaren e Francës. Zidane ende nuk është në stolin e ndonjë skuadre që kur dha dorëheqje nga Real Madridi nga viti 2021, ndërsa gjatë kësaj periudhe refuzoi Juventusin e Man Unitedin. Në një intervistë për Gianluca di Marzion, Zidane e la të hapur mundësinë që të marrë

drejtimin e “Zonjës së Vjetër”, megjithatë aktualisht fokusi i tij mbetet Franca. “Padyshim do të rikthehem si trajner. Juventus? Nuk e di pse nuk ndodhi. Ende i kam në zemër sepse më kanë dhënë shumë, nuk e di, por një ndër qëllimet e mia është ta drejtoj kombëtaren e Francës. Të shohim”, ka thënë Zidane. Zidane shihet si favorit edhe te Federata Franceze, e cila po

kërkon zëvendësuesin e Didier Deschamps që i ka informuar të gjithë se do të largohet pas Kupës së Botës 2026. Gjatë dy periudhave te Real Madridi (2016-2018, pastaj 2019-2021), Zidane ka fituar 11 trofe, përfshirë tri herë radhazi Ligën e Kampionëve, dy tituj të La Ligës, dy superkupa të Spanjës, dy superkupa evropiane si dhe dy herë Kupën e Botës për klube.

AL HILAL OFRON 400 MILIONË EURO PËR YAMALIN

BARCELONË, 13 TETOR - Lamine Yamal, talenti i Barcelonës, është në qendër të një stuhie mediatike pas një oferte historike prej 400 milionë eurosh nga klubi saudit Al-Hilal. Ky transferim mund të shënojë shifrën më të lartë në historinë e futbollit botëror. Me vetëm 18 vjeç, Yamal ka lënë gjurmë të pashlyeshme te Barcelona, por edhe te Spanja. Zgjatja e kontratës së tij me

Barcelonën deri në vitin 2031, me një pagë vjetore afërsisht 21 milionë euro, tregon besimin e klubit te potenciali i tij. Megjithatë, oferta e Al-Hilalit ka hedhur hije mbi të ardhmen e tij në “Camp Nou”. Klubi saudit ka ofruar 400 milionë euro për Yamal, një shumë që tejkalon ndjeshëm vlerën e tij aktuale në treg dhe, gjithashtu, përfshin një kontratë

prej shtatë sezonesh për talentin e ri spanjoll, raporton “Fichajes”. Raportimet tregojnë se Barcelona ka refuzuar fillimisht këtë propozim, duke theksuar dëshirën për ta mbajtur Yamal si një pjesë kyçe të projektit sportiv, por presioni financiar dhe ambiciet e lojtarit mund të komplikojnë situatën. Yamali po monitorohet edhe nga Paris Saint-Germaini.



SALAH DREJT GALATASARAYT



LIVERPOOL, 13 TETOR - Gjiganti turk Galatasaray po përgatit një lëvizje të bujshme për ta transferuar anësin e Liverpoolit, Mohamed Salah, me një marrëveshje të mundshme që mund të ndodhë që në afatin kalimtar të janarit. Mediumet në Turqi raportojnë se sulmuesi egjiptian është i hapur ndaj një kalimi në Superligën turke, pasi është impresionuar nga atmosfera elektrizuese e tifozëve të Galatasaray gjatë ndeshjes së fundit që Liverpool zhvilloi në stadiumin “RAMS Park”.

Gjithnjë sipas “Nefes”, që ka raportuar me burime pranë klubit turk, një marrëveshje mund të finalizohet gjatë ditës së dimrit megjithatë, nëse negociatat nuk përmbillen në kohë, transferimi mund të shtyhet për më vonë. Salah, 33 vjeç, është një nga lojtarët më të suksesshëm në historinë e Liverpoolit, me mbi 180 gola në Ligën Premier dhe një sërë trofesh të fituar, përfshirë Ligën e Kampionëve dhe kampionatin anglez. Kontrata e tij me Liverpoolin është e

vlefshme deri në verën e vitit 2027, ndërsa vlera e tij aktuale në treg është rreth 50 milionë euro. Një kalim i mundshëm në Turqi do të përbënte një nga transferimet më të mëdha në historinë e Superligës dhe do të sillte një ndikim të jashtëzakonshëm mediatik dhe sportiv për Galatasarayn. Salah është pjesë e Liverpoolit që nga viti 2017 kur iu bashkua nga Roma për 42 milionë euro, ndërsa këtë sezon në 10 ndeshje ka shënuar vetëm tre gola dhe ka po aq asistime.

SUAREZI NË MESIN E LEGJENDAVE, 600 GOLA NË KARRIERË: NËSE JU THEM SE I ËNDËRROJA, JU GËNJJEJ

MIAMI, 13 TETOR - Luis Suarez ka arritur shifrën e 600 golave në karrierë. Në fundjavën që shkoi uruguiani ka arritur të shënojë në fitoren 4:0 të Inter Miamit kundër Atlanta Unitedit në ligën MLS. 38-vjeçari në karrierën e tij të lavdishme ka fituar gjithçka që është e mundur: një Champions, një Botëror të Klubeve, 5 La Liga, 4 Copa del Rey, dy Superkupa të Spanjës, pastaj ka triumfuar edhe në Angli një herë në Kupën e Ligës, derisa në Holandë një titull në Eredivisie dhe një Kupë

nacionale. Në Brazil me Gremion ka fituar dy kampionate Gauch, kurse në Uruguai tri kampionate, derisa me Kombëtaren e Uruguait e ka fituar Copa American. Në nivelin individual, Suarez ka fituar shtatë herë titullin e golashënuesit më të mirë në kompeticione të ndryshme, ndërsa e ka fituar dy herë edhe Këpucën e Artë. Ai është golashënuesi më i mirë në histori të Kombëtares së Uruguait me 69 gola në 143 ndeshje. Vetë Suarez i ka komentuar këtë

arritje me një postim në llogaritë e tij në rrjetet sociale. “Nëse ju them se i kam ëndërruar, ju gënjej. Kurrë nuk kam mundur të besoja se do të arrija aq shumë në karrierë. U jam falënderues krejt klubeve ku kam luajtur, pastaj Seleccion, bashkëlojtarëve, trajnerëve, zyrtarëve, punëtorëve të ndryshëm në klube, familjes sime dhe tifozëve. Krejt këta bëjnë pjesë në këtë objektiv të arritur. Gjithmonë ekziston një faqe më shumë...”, ka shkruar një prej sulmuesve më të mirë në Evropë në 15 vjetet e fundit.



F2.2/BNJ



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, posebno člana 8, na osnovu Uredbe br. 07/2024 o radnom odnosu u RPO "Pastrimi" a.d. konkretno član 11, stavovi 1.2 i 12, na osnovu Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "Pastrimi" a.d. A, na osnovu Odluke od 10.10.2025. godine sa brojem protokola 02/01/782 izvršnog direktora RPO-a "Pastrimi" A.D, objavite ovo:

REDOVNI JAVNI KONKURS (KP/RR)
Za popunjavanje posla

Naziv posla: "Blagajnik u Porti blaganje"
Ne. Potreban: Jedna (1) pozicija, NJO-Lipjan u RPO "Pastrimi" A.D
Referentni broj: KJ / RR / NJOL / 32-2025
Koeficijenti/Mesečna plata: Nivo XIV
Trajanje ugovora o radu: Na neodređeno vreme
Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1. vrši gotovinska plaćanja od potrošača i brine se o njihovom brojanju i tačnosti;
- 1.2. Isporučuje sav dobro izračunati novac u roku od jednog dana u najbližu banku ili, po potrebi, na glavnu blagajnu kompanije;
- 1.3. Svaki put treba voditi računa o identifikaciji kupca, registraciji i brojanju novca i evidentiranju uplata na računaru;
- 1.4. prima razne informacije i pritužbe u vezi sa problemima potrošača i obaveštava šefa Jedinice za pozive i brigu o potrošačima "Pozivni centar" o istom;
- 1.5. priprema izveštaje o plaćanju i odmah ih dostavlja finansijskom službeniku radi evidentiranja plaćanja;
- 1.6. Napravio je svakodnevno izjednačavanje pogodbe između odnosa sistema i raspoloživih sredstava;
- 1.7. Izveštaj banke kao dokaz da su sredstva isporučena šalje se odgovarajućoj službi, potpisana i određena u skladu sa datumima;
- 1.8.Za svaku uplatu, čuvajte kopije kao dokaz potpisan od strane obe strane;
- 1.9. brine o primljenim sredstvima verifikujući ih odgovarajućom opremom;
- 1.10. Čuvati kasu i finansijski materijal u redu i spreman za mesečnu registraciju;
- 1.11 U skladu sa potrebama i redosledom šefa službe, on obavlja i druge poslove u oblasti svoje delatnosti;
- 1.12 svakodnevno objavljuje izveštaje na kraju radnog vremena direktno u sistemu;
- 1.13. šalje izveštaj šefu službe radi upoređivanja i periodičnih provera;
- 1.14. Sve poruke moraju biti na vreme, svaki dan poruke moraju biti tako da na kraju meseca su svi postavljeni, najkasnije do 1. u narednom mesecu.
- 1.15. Brine o popunjenim izveštajima tako što ih uređuje u određenu datoteku. Obavezna je da se striktno pridržava radnog vremena i nije dozvoljeno zatvaranje tačke u radno vreme.
- 1.16. Obavlja druge poslove i izveštava rukovodioca operativne jedinice.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ Budite državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- Potrebno obrazovanje: Srednje obrazovanje
- ✓ Radno iskustvo Potrebno: 2 godine profesionalnog rada u oblasti finansija

4. Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Veštine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i formulisane stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih profesionalnih presuda i diskrecije o pitanjima i značajnog doprinosa razvoju i implementaciji politike;
- ✓ Veliko znanje iz oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose kao deo prijave i kako ih dostaviti

Zahtev za zapošljavanje i CV, popunjen i potpisan od strane kandidata	✓
Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova	✓
Kopije dokaza o zaposlenju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije ocena rada za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Identifikacioni dokument Republike Kosovo	✓
Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci	✓

6. Kako se prijaviti na konkurs i poslati prijavu:

6.1 Povlačenje zvaničnih obrazaca se vrši:

- * preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" a.d.
- * na recepciji kompanije.

6.2 Podnošenje prijave:

- * Prijava za zapošljavanje, sa popunjenom dokumentacijom, podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i
- * U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 14.10.2025. do 28.10.2025. godine.
Rok za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće biti razmatrane.

8. Metod evaluacije i kriterijumi ocenjivanja.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prohodnost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ Pismeni test: do 60 bodova
- ✓ CV kandidata: do 10 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 30 bodova.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Great Plains L.L.C – Prishtinë me nr. të protokolit 5210/25 të datës 04.07.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Lubovë 70806030, me numër të parcelave: 00015-3; 00016-0; 00018-0; 00019-0; 00020-0; 00029-1; 00029-2; 00029-3; 00030-1; 00030-2; 00030-3; 00030-4; 00030-5; 00030-6; 00030-7; 00030-8; 00035-0; 00036-0; 00037-1; 00037-2; 00038-0; 00039-0; 00040-0; 00041-1; 00041-2; 00043-3; 00044-0; 00045-0; 00046-1; 00046-2; 00047-1; 00047-2; 00048-0; 00049-1; 00049-2; 00049-3; 00055-0; 00056-1; 00056-2; 00057-1; 00057-2; 00057-3; 00058-0; 00068-0; 00069-0; 00070-0; 00071-0; 00072-1; 00072-2; 00078-1; 00078-2; 00078-3; 00078-4; 00079-0; 00081-0; 00082-0; 00084-0; 00085-0; 00358-0; 00359-0; 00360-0; 00361-1; 00361-2; 00362-1; 00363-1; 00363-3; 00365-0; 00366-0; 00367-0; 00370-0; 00371-0; 00372-0; 00373-2; 00373-3; 00381-0; 00382-0; 00383-0; 00384-0; 00385-1; 00385-2; 00387-1; 00387-2; 00387-3; 00387-4; 00387-5; 00387-6; 00387-7; 00388-1; 00388-2; 00388-3; 00520-3; 00521-0; 00523-0; 00524-1; 00525-0; 00536-0; 00538-2; 00539-1; 00539-2; 00539-3; 00539-4; 00546-1; 00546-2; 00546-5; 00547-0; 00548-0; 00549-0; 00550-1; 00550-2; 00551-0; 00552-1; 00552-2; 00552-4; 00552-5; 00553-0; 00555-1; 00555-3; 00556-0; 00557-0; 00558-0; 00559-0; 00560-1; 00563-2; 00565-2, me sipërfaqe totale prej 109.838 m² që ndodhen në Komunën e Istogut.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaik “Parkut Fotovoltaik në Lubovë 100 MW” Z.K. Lubovë- Istog” për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.24.10.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara: Kushtet Ndërtimore të propozuara: Great Plains L.L.C	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 5, 6 dhe 7/ Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	- m’
c. Vija e ndërtimit.	5-7 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5-3.0 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	2.5-3.0 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	0.18 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	91.63 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	7
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- N.P.T. “Adria-7 Elektro” me nr. Unik Identifikues: 811882035 shpall të pavlefshme certifikatën TVSH-së, me nr. 330498578.

Advije Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën Bachelor, të Fakultetit të Edukimit programi Fillor të Universitetit të Prishtinës me nr. 468.

- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.

- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

U bënë 18 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



Milaim H. Misini
(23.04.1938 - 13.10.2008)

Vdekja të ndau nga Jeta, por jo nga zemrat tona.
E përkujtojnë Familja Misini nga Prishtina dhe Korretica e Ulët.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L